



Datë: 10.06.2025
Numër Protokolli: 3978/2025

A.nr.640/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.640/2025, të datës 11.04.2025, të parashtruar nga ankuesja V.M., kundër organit të punësimit/Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.640/2025, e datës 11.04.2025, e parashtruar nga ankuesja V.M.

II. Detyrohet Kryetari i Komunës dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në Komunën e Klinës, që brenda afatit prej pesëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet administrative në kuptim të klasifikimit të pozitës së ankueses në pajtim me Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbim Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, V.M. (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 24.04.2025 përmes emailit ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos lëshimit të Aktit të emërimit dhe mos realizimit të pagës sipas klasës profesional 2, koeficienti 4.9 sipas Katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 18.04.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa, kjo e fundit më datë 24.04.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosijes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3225/2025 të datës 19.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2396/2025 të datës 11.04.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; E-mailin e datës 14.03.2025; E-mailin e datës 13.03.2025; Vendimin nr. 08/226, të datës 23.10.2024; Konkursin me numër Reference RN00015978 të datës 06.12.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.04.2025; Përgjigjen në ankesë të 24.04.2025; Akt emërimit me numër protokolli 02 Nr.112-29918/2024 të datës 03.09.2024; Akt emërimit e datës 01.08.2011; Diplomën me Nr.2026/21 të datës 15.10.2021; Formularet e vlerësimit të rezultateve të punës; Përshkrimin e detyrave të punës; Lista e pagave të ankueses; Vendimin me numër protokolli 02 Nr.112-23786 të datës 30.07.2024; Njoftimin e datës 28.01.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e bazuar, sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 02 Nr.112-29918/2024, të datës 03.09.2024, është i punësuar në pozitën *Zyrtare për Gjendje Civile* në Komunën e Klinës, në kategorinë profesionale, klasa profesional 3 me klasë dhe koeficient GJ45, 3.92.

Më tej, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja më datë 13.03.2025, përmes postës elektronike ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës që të zbatohet katalogu i ri i vendeve të punës për shërbimin civil, në atë mënyrë që pozita e saj të klasifikohet nga klasa profesional 3 në klasën profesional 2, ndërsa, ky i fundit më datë 14.03.2025, ka njoftuar ankuesen me njoftimin si vijon: *Komuna ka miratuar buxhetin për vitin fiskal 2025 dhe është planifikuar për pozitat e tilla koeficienti e pagës (3.92), dhe për rrjedhojë pas miratimit të katalogut të vendeve të punës i jemi drejtuar Zyrtarit Kryesor Financiar me kërkesë për të kërkuar konfirmimin për mjete buxhetore dhe meqenëse nuk kemi marr përgjigje nuk mund të veprojmë me ndërrimin e akt emërimeve, duke e udhëzuar që mund të parashtrorj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se sipas Katalogut të vendeve të punës i miratuar, me Vendimin nr. 08/226, datë 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Zyrtarët e Gjendjes Civile janë klasifikuar në klasën profesionale 2, pra kalojnë nga Profesional 3, në Profesional 2 (pika 118 e katalogut të vendeve të punës, Kodi SHC-1118), andaj kërkon nga Këshilli që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar, të obligohet Komuna e Klinës të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit si dhe ekzistimin e pagës sipas koeficientit të ekuivalencës së klasës së pagës për kategorinë e nivelit profesional 2, në mënyrë retroaktive nga dita e hyrjes në fuqi të katalogut të vendeve të punës.

Në kuptim të themelësisë dhe bazueshmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,.. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196*

për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Në kontekst të konstatimit si më sipër, Rregullorja (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përcakton:

- **Neni 22**, 1. Çdo vend pune në shërbimin civil, është pjesë e një prej klasave në shërbimit civil të përcaktuara sipas kësaj Rregullore. 2. Çdo pozitë konkrete e kategorisë profesionale, klasifikohet si pjesë e një prej tri (3) klasave të kategorisë përkatëse. 3. Klasifikimi i një pozite në kategorinë e profesionale apo të specialistëve bëhet në bazë të procesit të vlerësimit dhe klasifikimit të punës në pajtim nën 21-26 kësaj Rregulloreje.

- **Neni 23**: 1. Klasifikimi i një vendi të punës të kategorisë së specialistëve dhe profesionale si pjesë e një prej klasave të parashikuara në nenin 14 dhe 15 të kësaj Rregullore, bëhet nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të nivelit të faktorëve të klasifikimit dhe të kriteret e përgjithshme të kërkuara. 12 2. Analiza e faktorëve të klasifikimit bëhet për çdo faktor mbështetur në përshkrimin e vendit përkatës të punës. 3. Karakteristikat që paraqet pozita konkrete sipas secilit faktor, krahasohen me karakteristikat e faktorëve të klasifikimit të përcaktuar për çdo klasë në pajtim me Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje. 4. Pozita vlerësohet e klasifikuar në atë klasë me karakteristikat sipas faktorëve të cilës ka më shumë ngjashmëri.

- **Neni 24**: Vlerësimi për klasifikimin e pozitave të punës të kategorisë të specialistëve dhe kategorisë profesionale, bëhet nga Grupi i Vlerësimit, çdo herë që përgatitet një Rregullore e organizimit të brendshëm të institucionit.

- **Neni 25**: 1. Grupi i vlerësimit për klasifikim themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit. 2. Grupi i vlerësimit për klasifikim përbëhet nga një përfaqësues i NJMBNJ-së, dhe nga nëpunës tjerë civilë me përvojë në institucionin përkatës.

- **Neni 26** 1. Grupi i Vlerësimit për Klasifikim analizon dhe vlerëson pozitën, harton propozimin për klasifikimin e pozitave dhe paraqet për veprime të mëtejshme tek drejtuesi më i lartë administrativ të institucionit. 2. Pas miratimit nga drejtuesi më i lartë i administrativ i institucionit, propozimi përfshihet në draftin e Rregullores së organizimit të institucionit.

- **Neni 27**: 1. Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit. 2. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Rrjedhimisht, bazuar në shkresat rezultojnë fakti se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, dhe si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve, pozita e ankueses nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë është ekuivalentuar më klasë GJ45 dhe koeficienti të pagës (3.92). Ndërsa, Komuna e Klinës më datë 30.05.2024 ka miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Klinës dhe sipas shtojcës nr.1 të kësaj rregullore pika 7, pozita zyrtar i gjendjes civil është klasifikuar në klasën Profesional 3, kurse pas përfundimit të procesit të ristrukturimit, ankueses i është lëshuar Akt Emërimit me numër protokolli e numër protokolli 02 Nr.112-29918/2024, të datës 03.09.2024, në kategorinë profesionale, klasa profesional 3, me klasë dhe koeficient të pagës GJ45 (3.92).

Tutje, Kolegji thekson faktin së Qeveria e Republikë së Kosovës, më Vendimin Nr. 08/226 të datës 23.10.2024, ka miratuar Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ku në pikën II të këtij

vendimi është përcaktuar: *Obligohen të gjitha institucionet që të përfundojnë klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog.*

Andaj, duke u bazuar në kuadrin ligjor si më lartë, Kolegji vlerëson së institucionet janë të obliguar që të përfundojnë procesin klasifikimin të vendeve të punës në pajtim me bazën ligjore në fuqi kështu që meqenëse Komuna e Klinës tashme ka të përfunduar procesin e klasifikimit dhe së më Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil pozita Zyrtar i Gjendjes Civile është klasifikuar me kodin SHC-1118, Klasa Profesional 2 dhe në grupin e shkencave shoqërore, atëherë, mbi këto rrethana të reja ligjore, organi i punësimit në këtë rast Komuna e Klinës është e detyruar që në pajtim me Rregulloren për Klasifikimin Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, të ndërmer veprime ligjore në kuptim të ri klasifikimit të vendeve të punës në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës, dhe rrjedhimisht edhe të pozitës së Zyrtarit të Gjendjes Civile.

Përmbledhur si ma lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.640/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses V.M.;
- Organit të punësimit: Kryetarit të Komunës, dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.